



KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT



Zyret qendrore
Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë
Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

Bazuar nenin 34 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjen Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009, dhe bazuar në nenin 7 të Statutit të Ndërmarrjes Publike K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A., Bordi i Drejtorëve i K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A.-Pejë, në mbledhjen e mbajtur me 30.07.2026, shqyrtoi aneksin II të rregullores mbi pagat dhe kompensimet tjera dhe lidhur me të njëjtin, njëzëri, mori këtë:

VENDIM NR 25

I. Miratohet Aneksi II i Rregullores mbi Pagat dhe Kompensimet tjera.

ARSYETIM

Bordi i Drejtorëve i K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A., Pejë, në mbledhjen e mbajtur më 30.07.2026, shqyrtoi Aneksin II të Rregullores mbi Pagat dhe Kompensimet tjera.

Bordi i Drejtorëve me qëllim të harmonizimit të pagës bazë minimale me legjislacionin në fuqi dhe përmirësimit të mirëqenies së të punësuarve miratoi Aneksin II të Rregullores mbi Pagat dhe Kompensimet tjera. Me Aneksin II të Rregullores mbi Pagat dhe Kompensimet tjera, koeficientët e të gjitha pozitave rriten për 0.25, duke mundësuar rritje lineare të pagës bazë prej 60.00 euro bruto në muaj për secilin të punësuar, ndërsa paga bazë minimale harmonizohet me pagën minimale të përcaktuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Për këto arsye, Bordi i Drejtorëve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve

Qendresa Kukaj – Prelvukaj



Ju dërgohet:

- Bordit të Drejtorëve;
- NjPMNP-së;
- Arkivit.